



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

06.10.2025, Prishtinë,
Ref:04.09.2025\1708-2025

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Arsim Halili kundër Kallxo.com**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 30 shtator 2025, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Arsim Halili kundër Kallxo.com, për publikimin e shkrimit me titull "Reagim ndaj fushatës shpifëse për kontratën e vitit 2017 mes BIRN-it dhe RTK-së", dhe mori këtë,

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M

Media ka publikuar shkrimin me titull "Reagim ndaj fushatës shpifëse për kontratën e vitit 2017 mes BIRN-it dhe RTK-së". Sipas palës ankuese, shkrimi i publikuar bie ndesh me kapitujt II (raportimi i së vërtetës) dhe IV (e drejta për t'u përgjigjiur) të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës.

Shkrimi është i publikuar në media online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar. Ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas shqyrtimit të ankesës, KMSHK gjen se ankesa është e bazuar. Pra, miratohet.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkrimit të publikuar në media, KMSHK konstaton se media ka publikuar një reagim, si përgjigje për pretendimet e palës ankuese ndaj organizatës BIRN. Shkrimi nuk ka qenë i shenjuar si "opinion" dhe as i publikuar në rubrikën e opinioneve. KMSHK konstaton se media në reagimin e publikuar është dashur që t'i përfshijë edhe pretendimet e palës tjetër, të cilave iu është përgjigjur në reagim, sepse bëhet fjalë për një çështje me interes për publikun. Në formën si është publikuar, nuk bëhet e qartë çfarë vërtet ka ndodhur. Media vetëm ka interpretuar pretendimet e palës tjetër, duke i cilësuar si shpifje, gjë që nuk është dashur ta bëjë. Po ashtu, media nuk është dashur të përdor etiketime për palën ankuese, pasi që shpifja e pretenduar nuk është vërtetuar nëpërmjet asnjë procedure gjyqësore. Në lidhje me këtë pikë, KMSHK konsideron se media ka bërë shkelje të Kapitullit II (raportimi i së vërtetës) të Kodit të Etikës.

Në lidhje me pikën e dytë, përkatësisht të drejtën për t'u përgjigjur, KMSHK gjen se, në mënyrë që raportimi të ishte i plotë, media është dashur ta përfshijë në shkrim qëndrimin, përkatësisht pretendimet e palës ankuese, gjë që nuk e ka bërë, duke mos e respektuar Kapitullin IV të Kodit të Etikës.

Andaj, KMSHK vendos që ankesa të miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës